



# **SRPSKA LISTA (SL)**

**Raportet Financiare Vjetore dhe Raporti i Auditorit të pavarur**

**01 Janar 2021 – 31 Dhjetor 2021**

**Përmbajtja:**

Raport i auditorëve të Pavarur.. .....	3
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	6
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	7
Shënimet e pasqyrave financiare.....	8-14

# Raport i Auditorëve të pavarur

## Drejtuar Kryesisë së "SRPSKA LISTA"

### Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

#### Mohim i Opinionit

Ne kemi qenë të angazhuar për të audituar raportet financiare bashkëngjitura të Subjektit Politik "SRPSKA LISTA" (në vijim referuar si "Subjekti Politik" apo "SL"), të përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2021, Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve për periudhën e përfunduar me këtë datë, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira në fq 6-14.

Ne nuk shprehim një opinion mbi raportet financiare të vitit 2021 të subjektit politik "SRPSKA LISTA". Për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në paragrafin bazat për mohim të dhënies së opinionit, ne nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit për të pasur një bazë për një opinion të auditimit.

#### Bazat për Mohim te dhënies Opinionit

- Subjekti Politik nuk ka plotësuar drejt pasurine, ekuitetin dhe detyrimet me 31 dhjetor 2021 dhe 2020, po ashtu shënimet e prezentuara në Pasqyra Financiare nuk mbështeten me dëshmi relevante lidhur me zërat e pasqyrave financiare të SP ashtu sic kërkohet me ligjin Nr. 04/L-212 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuara dhe plotësuara me ligjin Nr. 04/L-058, Neni 15 Raportimi Financiar. Duke pas parasysh natyrën e shenimeve që mban subjekti politik ne e kishim të pamundur të percaktojm korrigjimet e nevojshme me 31 Dhjetor 2021. Për me teper gjate auditimit ton ne kemi konstatuar që subjekti politik ka deklaruar shpenzime që ju takojne viteve paraprake ne vitin 2021 dhe ne e kishim të pamundur të percaktojm nese keto shpenzime jane njohur ne periudhat e mehereshme raportuese.
- Ashtu siç është shpalosur ne shënimin 2 te pasqyrave financiare përcjellëse, Shpenzimet, subjekti politik, Srpska Lista ka deklaruar shpenzime për Reklama, reprezentacion dhe konferenca vlerën prej 156,317.00 Euro. Prej te cilave, për shpenzimet e raportuara ne vlere prej 150,000.00 Euro, SP Srpska Lista nuk ka dokumentacion mbështetës që tregon se shpenzimet e paguara kanë ndërlidhje me aktivitetin politik te Subjektit politik, bazuar në Ligji Nr. 04/L-058/ për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve Politike. Neni 3 pika 1.1 deri 1.5. Ngase SP Srpska Lista nuk ka të formuara njësi përkatëse të organizimit të grave dhe të rinjve. Subjekti politik për këto pagesa te kryera ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me tri Organizata Jo-Qeveritare me vlerë kontrate nga 50,000.00 Euro. Duke qene se faturat janë paguar 100% ne momentin e nënshkrimit të kontratës tre muaj para se te behet pranimi i shërbimeve. Nga dëshmitë përkatëse ne nuk jemi te bindur se janë kryer shërbimet përkatëse për vlerën e këtyre shpenzimeve, dhe nuk kemi dokumentacion mbështetës për ndodhjen dhe saktësinë e tyre. Raportet narrative dhe financiare për këto kontrata janë pranuar pa bërë verifikimin e kryerjes se shërbimeve.
- Gjate auditimit ne kemi konstatuar se subjekti politik ka nënvlerësuar te hyrat e raportuara pasi që nuk ka prezantuar te hyrat nga kontributet e pranuar nga OJQ-Zhenski Kulturni Center ne vlere 5,000.00 Euro. Shih Oferta nga OJQ- Zhenski Kulturni Center me Nr:001/0821date 08.08.2021 ne shumë prej 55,000.00Euro,si dhe Kontrata Nr:33/21 date 30.08.2021,ku ceket: Fondi për realizim te projektit është 55,000.00 Euro

gjithsejta kontributi nga Srpska Lista 50,000.00 Euro dhe kontributi i kësaj OJQ-je për këtë projekt prej 5,000.00 Euro.

- Gjate auditimit ne kemi konstatuar se Subjekti politik Srpska Lista në shpenzimet e deklaruar ka përfshirë transaksionet me biznese te cilat figurojnë si tatimpagues jo-aktiv në Administratën Tatimore të Kosovës në vitin përkatës 2021, Shuma totale e faturave nga biznesi joaktiv ne ATK janë 1,200.00 Euro

### **Theksim i çështjes**

Ne po ashtu tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik ne shumicen e blerjeve qe ka kryer, nuk ka aplikuar ndonjë procedur te tenderimit e cila do te mundësonte një shfrytëzim sa më efikas, me kosto ekonomike, transparente dhe të drejtë të fondeve të subjektit politik.
- Subjekti Politik e ka të definuar me statut kontrollin e brendshëm financiar, me statut është parapare qe me një akt te veçantë te Bordit Mbikëqyrës te definohet mbikëqyrja dhe kontrolli financiare, por qe mungon një akt i tillë i veçantë i Organit Mbikëqyrës te SP, i cili do ta definonte qarte Kontrollin e brendshëm financiar, mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar me qëllim të luftimit të praktikave korruptive dhe ngritjes dhe forcimit të menaxhimit financiar dhe transparencës për të drejtën e anëtarëve për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjektit politik si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksione financiare, ashtu siç parashihet ne Neni 17 “Kontrolli i Brendshëm” të Ligjit Nr.03/L-174 “Për financimin e subjekteve politike” i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-212.Megjithate,SP ka krye një Auditim të Brendshëm- AB financiar për vitin përkatës 2021.

### **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj(parimi i vijimësisë),shpalosjen, sipas rastit, te çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës se kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuideojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Subjektit Politik.

### **Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi,dhe për të nxjerrë raportin e një audituesit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit.

Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Subjektit Politik.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijmësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

## **Audit & Conto sh.p.k**

---

**Nijazi Jakupi**  
**Auditor Ligjor**  
**18 Tetor 2023**

**Pasqyra e Pozitës Financiare**

<b>Pasuritë</b>		<b>Me 31 Dhjetor 2021</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2020</b>
<b>Pasuritë afatgjata</b>	Shënimi	<b>Shuma në Euro</b>	<b>Shuma në Euro</b>
Toka, objektet dhe pajisjet	5	7,600.00	0.00
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			
<b>Total pasuritë afatgjata</b>		<b>7,600.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Pasuritë afatshkurtra</b>			
Llogaritë e arkëtueshme	6	0.00	0.00
Parapagimet			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	7	107,653.85	98,214.32
Pasuritë tjera afatshkurtra			
<b>Total pasuritë afatshkurtra</b>		<b>107,653.85</b>	<b>98,214.32</b>
<b>Total pasuritë</b>		<b>115,235.85</b>	<b>98,214.32</b>
<b>Ekuiteti</b>			
Fondet e akumuluar		98,214.32	
Suficiti / (deficiti) i vitit		551.93	98,214.32
<b>Total Ekuiteti</b>		<b>98,766.25</b>	<b>98,214.32</b>
<b>Detyrimet</b>			
<b>Detyrimet afatgjata</b>			
Huatë e pagueshme			
Të hyrat e shtyra		7,600.00	0.00
<b>Gjithsej detyrimet afatgjata</b>		<b>7,600.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	8	8,458.46	0.00
Huatë e pagueshme		157.48	0.00
Detyrimet tjera afatshkurtra	9	253.66	0.00
<b>Gjithsej detyrimet afatshkurtra</b>		<b>8,869.60</b>	<b>0.00</b>
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>16,469.60</b>	<b>0.00</b>
<b>Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet</b>		<b>115,235.85</b>	<b>98,214.32</b>

**Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve**

	Shënimi	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
		2021	2020
<b>Të hyrat</b>			
Të hyrat nga buxheti		318,614.71	355,225.66
Të hyrat nga anëtarësia			
Donacionet dhe kontributet në të holla	3	0.00	0.00
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime	4		
Të hyrat e fushatës			
Te hyrat e liruar nga te hyrat e shtyra	5		
Të hyrat tjera			
<b>Gjithsej të hyrat për vitin</b>		<b>318,614.71</b>	<b>355,225.66</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Pagat dhe kompensimet	2	35,755.09	19,775.62
Shpenzimet e transportit	2	7,188.62	4,613.35
Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	2	156,317.00	155,360.50
Shpenzimet e fushatës	2	44,250.00	43,862.00
Blerja e mallrave	2	0.00	0.00
Shpenzimet e përgjithshme	2	35,716.32	30,020.57
Shpenzimet e ndryshme	2	38,835.75	3,379.30
<b>Gjithsej shpenzimet për vitin</b>		<b>318,062.78</b>	<b>257,011.34</b>
<b>Suficiti / (deficiti) për vitin</b>		<b>551.93</b>	<b>98,214.32</b>

## 1. Informata të përgjithshme

Subjekti Politikë: Srpska Lista  
Akronimi: SL  
Selija: Mitrovicë Veri  
Web faqja: <http://www.srpskalista.net/>  
NF: 601543730  
E regjistruar: 12.05.2017 numri regjistrues 209-0517  
Kryetar : Goran Rakić  
Përf.i autorizuar ///////////////  
Përf.Financier: Darko Radovanovic

Pasqyrat financiare te Partisë “SRPSKA LISTA” janë përgatitur sipas kërkesave te Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.Bazuar në nenin 19 paragrafi 2 pika 7 e Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit.Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058.

Subjekti Politik mirëmban vetëm një llogari te vetme bankare ne bankën BKT.



**Shënimi 2. Shpenzimet**

<b>Shpenzimet</b>	<b>Shpenzimi në Euro</b>	<b>Pagesa në Euro</b>	<b>Borxhi i mbetur në Euro</b>
<b>Pagat dhe kompensimet</b>			
Pagat dhe kompensimet, neto	30,350.22	30,350.22	0.00
Kontributet pensionale të punëmarrësit			0.00
Kontributet pensionale të punëdhënësit	3,405.06	3,151.40	253.66
Tatimet në të ardhura personale	1,999.81	1,842.33	157.48
Beneficionet tjera			0.00
<b>Gjithsej</b>	<b>35,755.09</b>	<b>35,343.95</b>	<b>411.14</b>
<b>Shpenzimet e transportit</b>			
Automjetet motorike të huazuara			0.00
Karburantet	6,674.79	6,097.34	577.45
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksitë etj.			0.00
Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave	513.83	513.83	0.00
Çdo shpenzim tjetër i transportit			0.00
<b>Gjithsej shpenzimet e transportit</b>	<b>7,188.62</b>	<b>6,611.17</b>	<b>577.45</b>
<b>Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat</b>			
Lokali			0.00
Ushqimi	5,550.00	5,500.00	0.00
Aktivitete kulturore dhe rekreative	150,000.00	150,000.00	0.00
Radio dhe spotet televizive	0.00	0.00	0.00
Stendat e afishimit dhe reklamimet në gazeta	767.00	767.00	0.00
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave	0.00	0.00	0.00
<b>Gjithsej reklamat, reprezentacioni dhe konferencat</b>	<b>156,317.00</b>	<b>156,317.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Shpenzimet e fushatës</b>			
Shpenzimet e fushatës	44,250.00	44,250.00	0.00

## SRPSKA LISTA

Shënime për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2021 deri më 31 Dhjetor 2021

<b>Gjithsej shpenzimet e fushatës</b>	<b>44,250.00</b>	<b>44,250.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Blerja e mallrave</b>			
Furnizimi i zyrës	0.00	0.00	0.00
Pajisjet të vogla			0.00
<b>Gjithsej blerja e mallrave</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Shpenzimet e përgjithshme</b>			
Qiraja e lokalit të zyrës	32,967.22	32,719.75	247.47
Telefoni, interneti dhe posta	849.10	849.10	0.00
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)			
Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë	1,900.00	////////////////////	////////////////////
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet në natyrë në mallra dhe shërbime	0.00	////////////////////	////////////////////
<b>Gjithsej shpenzimet e përgjithshme</b>	<b>35,716.32</b>	<b>33,568.85</b>	<b>247.47</b>
<b>Shpenzimet e ndryshme</b>			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës	0.00	0.00	0.00
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër	38,835.75	31,202.21	7,633.54
<b>Gjithsej shpenzimet e ndryshme</b>	<b>38,835.75</b>	<b>31,202.21</b>	<b>7,633.54</b>
<b>Gjithsej shpenzimet</b>	<b>318,062.78</b>	<b>307,293.18</b>	<b>8,869.60</b>

**Shënimi 3: Donacionet dhe kontributet në të holla për vitin 2021**

Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera në euro	E pranuar përmes:	
Kontribuesi	Adresa	Numri personal			Bankë	Arkë
<b>Gjithsej donacionet dhe kontributet në të holla</b>				////////	////////////////	////////////////

**Shënimi 4: Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime**

Përshkrimi i mallit / shërbimit	Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera në euro
	Kontribuesi	Adresa	Numri personal		
<b>Gjithsej kontributet në natyrë në mall dhe shërbime</b>					////////////////

**Shënimi 5: Toka, objektet dhe pajisjet**

	Bilanci në fillim të vitit (kosto historike)	Blerjet gjatë vitit	Zhvlerësimi i akumuluar	Zhvlerësimi i vitit	Bilanci në fund të vitit (vlera neto)
Toka			////////	////////	
Objektet					
Veturat	0.00	9,500.00	0.00	1,900.00	7,600.00
Pajisjet e zyrës					
Pajisjet e teknologjisë informative					
Pajisjet tjera					
<b>Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet</b>	<b>0.00</b>	<b>9,500.00</b>	<b>0.00</b>	<b>1,900.00</b>	<b>7,600.00</b>

**Shënime tjera**

<b>Shënimi 6. Llogari të arkëtueshme</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2021 Shuma në Euro</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2020 Shuma në Euro</b>
Bleresi -1		
Bleresi -2		
Llogari tjera te arketueshme		
<b>Gjithsej Llogarit e arkëtueshme</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>

<b>Shënimi 7. Paraja dhe ekuivalentët e parasë</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2021 Shuma në Euro</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2020 Shuma në Euro</b>
Paraja në bankë	107,635.85	98,214.32
Paraja në arkë		
<b>Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë</b>	<b>107,635.85</b>	<b>98,214.32</b>

<b>Shënimi 8. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2021 Shuma në Euro</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2020 Shuma në Euro</b>
Ratko Pavlovic BI	577.45	
Slavolub Mandic BI	60.00	
Atk	7,573.51	
Të tjerë		
<b>Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera</b>	<b>8,210.96</b>	<b>0.00</b>

<b>Shënimi 9. Detyrimet tjera afatshkurtra</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2021 Shuma në Euro</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2020 Shuma në Euro</b>
Detyrimet për paga dhe tatime	411.14	
Detyrimet për qira	247.25	
Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime		
Detyrime tjera afatshkurtër (huazimet)		
<b>Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra</b>	<b>658.39</b>	<b>0.00</b>

**Shënimi 10: Pagesat mbi 5,000.00 Euro**

Qëllimi i pagesës	Paguat ndaj:			Data kur është bërë pagesa	Vlera në euro
	Personi Fizik/Juridik	Adresa	Numri personal		
Qiraja e Lokaleve afariste	Rados Petrovic	Anke Spajic 70 Mitrovice	1501515520	05.01.2021	30,000.00
(Trening /Seminar/Konferenca)	NVO-Zenski Kulturni Centar za nove ideje	Prote Stojana 24.Zveqan	5116835-6	03.09.2021	50,000.00
(Trening /Seminar/Konferenca)	Alpinski Klub Oblak /Extrem Sport Asociations	Car Dusana 20 Zveqan	5116829-1	26.05.2021	50,000.00
Trening /Seminar/Konferenca)	Zenski Kulturni Centar	Zirkovac BB Zveqan	5117046-6	12.01.2021	50,000.00
Denime Atk (Kazne )	Atk	Bill Klinton Prishtine	N/A	07.09.2021	4,500.00
Denime Atk (Kazne )	Atk	Bill Klinton Prishtine	N/A	07.12.2021	2,500.00
Denime KQZ (Kazne )	KQZ	RR.Migjeni Pn Prishtine	N/A	16.08.2021	1,000.00
Denime KQZ (Kazne )	KQZ	RR.Migjeni Pn Prishtine	N/A	08.11.2021	8,100.00
Denime KQZ (Kazne )	KQZ	RR.Migjeni Pn Prishtine	N/A	24.11.2021	10,100.00
Troskovi Goriva	Sekos STP	Zveqan	810698368	13.01.2021	214.80
Troskovi Goriva	Sekos STP	Zveqan	810698368	11.02.2021	309.00
Troskovi Goriva	Sekos STP	Zveqan	810698368	11.03.2021	327.78
Troskovi Goriva	Sekos STP	Zveqan	810698368	22.04.2021	281.43
Troskovi Goriva	Sekos STP	Zveqan	810698368	17.05.2021	1,430.11
Troskovi Goriva	Sekos STP	Zveqan	810698368	15.06.2021	411.98
Troskovi Goriva	Sekos STP	Zveqan	810698368	19.07.2021	631.52
Troskovi Goriva	Sekos STP	Zveqan	810698368	23.09.2021	673.11
Troskovi Goriva	Sekos STP	Zveqan	810698368	04.11.2021	391.00

SRPSKA LISTA

Shënime për Pasqyrat Financiare Vjetore 01 Janar 2021 deri me 31 Dhjetor 2021

Troskovi Goriva	Sekos STP	Zveqan	810698368	04.11.2021	477.49
Troskovi Goriva	Sekos STP	Zveqan	810698368	07.12.2021	541.65
Troskovi Goriva	Sekos STP	Zveqan	810698368	03.02.2021	4,625.00
Marketing	Lubisav Arsic	Ka S/1 37	810048034	04.02.2021	1,650.00
Marketing	Lubisav Arsic	Ka S/1 37	810048034	08.02.2021	2,040.00
Usluge Reprerentacije	SUR Mirna Dolina Mitrovica e Veriut	Josevik Zvecn	601543730	22.02.2021	2,775.00
Usluge Reprerentacije	SUR Mirna Dolina	Josevik Zvecn	601543730	23.02.2021	2,775.00
Usluge Reprerentacije	SUR Mirna Dolina	Josevik Zvecn	601543730	22.04.2021	3,000.00
Usluge Reprerentacije	SUR Mirna Dolina	Josevik Zvecn	601543730	04.11.2021	90.00
Auto	Ibrahim Sylejmani	Vragoli Fushe Kosove	1014313245	03.06.2021	9,500.00
Marketing	Jovana Ajdukovic	M.Veriore Čika Jovina 3/2	811167007	03.06.2021	4,900.00
Marketing	Jovana Ajdukovic	M.Veriore Čika Jovina 3/2	811167007	04.02.2021	3,460.00
Marketing	Jovana Ajdukovic	M.Veriore Čika Jovina 3/2	811167007	05.02.2021	4,200.00
Marketing	Jovana Ajdukovic	M.Veriore Čika Jovina 3/2	811167007	08.02.2021	1,125.00
<b>Gjithsej pagesat mbi 5,000.00 Euro</b>					<b>252,029.87</b>